

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6984
E enjte, 31 gusht 2023
Çmimi 0.40

Konjufca: Kur bllokohet parlamenti, nuk bllokohet LV-ja e as Kurti por republika



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SHËNOHET DITA NDËRKOMBËTARE E PERSONAVE TË ZHDUKUR ME DHUNË

KOSOVA KËRKON NGA NDËRKOMBËTARËT T'I BËHET TRYSNI SERBISË PËR TË ZHDUKURIT ME DHUNË

FACE 4-5



Me rastin e 30 gushtit, Ditës Ndërkombëtare të të Zhdukurve me Dhunë, presidentja Vjosa Osmani së bashku me kryeparlamentarin Glauk Konjufca, kanë bërë homazhe dhe vendosur lule pranë memorialit përkujtimor

dedikuar të zhdukurve me dhunë gjatë luftës në Kosovë. Osmani ka thënë se Serbia po vazhdon ta përsërisë krimin e saj duke e fshehur vendndodhjen e personave të zhdukur me dhunë gjatë luftës së viteve 1998-1999 në

Kosovë. Ndërkaq Konjufca i ka bërë thirrje bashkësisë evropiane dhe faktorëve të tjerë vendimmarrës që të bëjnë trysni te institucionet në Serbi që të zbardhet e vërteta për mijëra të zhdukur, për të cilët është përgjegjës shteti serb

BLERJA E LIBRAVE, NAGAVCI: PRINDËRIT TË MOS I BLEJNË PA PRANUAR LISTËN NGA ANA E MËSIMDHËNËSVE

FACE 5



PACIENTËT NUK U TRAJTUAN NË MËNYRË TË BARABARTË DHE EFEKTIVE NGA FONDI PËR SIGURIMË SHËNDETËSORE

FACE 7



AKTUALE



SHBA ME PAKO TË RE TË NDIHMËS USHTARAKE PËR UKRAINËN

F. 2

OSMANI: PEZULLIMI I VENDIMIT PËR VIZA E VRET DIALOGUN

F. 3

NËNSHKRUHET MARRËVESHJA PËR NDËRTIMIN E OKMF-SË NË VLERË MBI 2 MILIONË EURO NË FERIZAJ

F. 7

EKONOMI




ISMAILI DHE PERANI PAJTOHEN PËR THELLIMIN E BASHKËPUNIMIT NDËRMJET BQK-së DHE IFC-së

F. 8

MINISTRIA E BUJQËSISË NDAN 24.6 MILIONË EURO PËR PROGRAMIN PËR ZHVILLIM RURAL 2023

F. 8

SPORT



TRI KLUBET SHQIPTARE KËRKOJNË FAZËN E GRUPEVE NË LIGËN E KONFERENCËS

F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
+389 44 487 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

ShBA me pako të re të ndihmës ushtarake për Ukrainën

WASHINGTON, 30 GUSHT - Shtetet e Bashkuara njoftuan më 29 gusht për një pakt të re të ndihmës ushtarake për Ukrainën që përfshin municione, raketa dhe ndihmë tjetër për Kievin në vlerë prej 250 milionë dollarësh. Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, tha përmes një deklarate se në paketën e re përfshihen pajisje për pastrimin e zonave nga minat, raketa për sistemet ajrore, municione për artileri, sisteme raketore të artilerisë me lëvizshmëri të lartë (HIMARS), dhe

mbi 3 milionë fishekë për armë të vogla. "ShBA-ja, aleatët dhe partnerët tanë do të qëndrojnë të bashkuar me Ukrainën për aq kohë sa të jetë e nevojshme", tha Blinken. Pakoja e ndihmës është financuar përmes fondeve të miratuara më herët nga Kongresi amerikan. Që nga nisja e pushtimit rus të Ukrainës në shkurt të vitit të kaluar, ShBA-ja i ka dërguar ndihmë ushtarake Ukrainës në vlerë prej mbi 43 miliardë dollarësh. Presidenti amerikan, Joe Biden, më herët gjatë këtij muaji i kërkoi

Kongresit që të miratojë ndihmë shtesë në vlerë prej 24 miliardë dollarësh. Si demokratët, ashtu edhe republikanët në Kongres kanë mbështetur ndihmën për Ukrainën, por disa republikanë të krahut të djathtë duan të pakësojnë ndihmën. Trupat ukrainase kanë nisur një kundërofensivë në lindje dhe jug të shtetit në qershor, por kanë bërë përparim të ngadalshëm drejt jugut për shkak se zona të mëdha janë minuar nga forcat ruse.



Kremlini thotë se avioni i Prigozhinit mund të jetë rrëzuar qëllimisht

MOSKË, 30 GUSHT - Kremlini ka thënë të mërkurën se hetuesit janë duke e konsideruar mundësinë që avioni, i cili po e bartte shefin mercenar Yevgeny Prigozhin, të jetë rrëzuar qëllimisht. "Është e qartë se po konsiderohen versione të ndryshme, përfshirë versionin - ju e dini se për çfarë e kam fjalën - të themi, një ligësi e qëllimshme", tha zëdhënësi i Kremlinit, Dmitri Peskov më 30 gusht kur u pyet për hetimin. I pyetur nëse Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil do ta hetojë rrëzimin e avionit, Peskov tha se rrethanat e bëjnë hetimin të dallojë, megjithëse e pranoi se hetuesit ende nuk kanë



ardhur në përfundim formal se çfarë e ka shkaktuar saktësisht rrëzimin e tij. "Të presim për rezultatet e hetimit rus", theksoi Peskov. Avioni privat Embraer, me të cilin

po udhëtonte Prigozhini nga Shën Peterburgut drejt Moskës, u rrëzua në veri të kryeqytetit rus duke i vrarë të gjithë 10 personat në bord më 23 gusht. Shkaktari nuk është gjetur ende,

por fshatarët afër vendit të ngjarjes kanë thënë për Reuters se e kishin dëgjuar një shpërthim të fuqishëm dhe pastaj e kishin parë avionin duke rënë në tokë. Avioni u rrëzua saktësisht dy muaj pasi Prigozhini e mori kontrollin e qytetit jugor të Rosisë, Rostov, në fund të qershorit, duke e nisur një kryengritje që e tronditi presidentin e Rosisë, Vladimir Putin. Rusia i ka njoftuar autoritetet braziliane se nuk do ta hetojë rrëzimin e avionit e prodhuar në Brazil, Embraer, sipas rregullave ndërkombëtare "tani për tani". I pyetur për këtë, Peskov tha: "Së pari, hetimi ka nisur, Komisioni Hetues është i angazhuar në këtë". "Në këtë rast, nuk mund të bëhet fjalë për ndonjë aspekt ndërkombëtar", tha Peskov.

Një ditë pas rrëzimit të avionit, Putini u shprehu ngushëllime familjeve të të vrarëve dhe tha se e kishte njohur Prigozhinin për një kohë shumë të gjatë, që nga fillimi i viteve të '90. "Ai [Prigozhin] ishte njeri me fat të keq, dhe ai bëri gabime serioze në jetë", tha Putin, derisa e përshkroi atë si biznesmen të talentuar. Kremlini i ka hedhur poshtë sugjerimet e disa politikanëve dhe komentatorëve të Perëndimit se Putini e kishte urdhëruar vrasjen e Prigozhinit për hakmarrje, duke i quajtur ato "gënjeshtër absolute". Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, tha se nuk ishte habitur nga vdekja e Prigozhinit dhe se ka pak gjëra në Rusi pas të cilave nuk qëndron Putini.

OKB-ja përgatitet për krizë humanitare në Niger

Nju Jork, 30 gusht- Kombet e Bashkuara kanë paralajmëruar se kriza politike në Niger dhe sanksionet e vendosura ndaj regjimit puçist rrezikojnë të shkaktojnë efekte "katastrofike" humanitare. Agjencia e OKB-së për refugjatë, UNHCR, tha se ka rishikuar planin e emergjencës për Nigerin, që kur gusht shteti ushtarak më 26 korrik rrëzoi nga pushtet presidentin, Mohamed Bazoum. "Krizat e

vazhdueshme politike, pa zgjidhje në horizont, po gjeneron paqartësi dhe shqetësime pasi shteti vazhdon të përballlet me sulme të vazhdueshme nga grupet e armatosura, veçmas afër kufijve me Malin dhe Burkina Fason", tha Emmanuel Gignac, përfaqësues i UNHCR-së në Niger. Me dhunën dhe sulmet që kanë detyruar të zhvendosen mbi 20.000 persona vetëm muajin e kaluar, ai paralajmëroi se "situata ka rritur



rreziqet për mbrojtjen e refugjatëve dhe azilkerkuesve". Gignac tha se mbyllja e kufijve dhe sanksionet e vendosura nga Komiteti Ekonomik i Shteteve të

Afrikës Perëndimore (ECOWAS) ndaj udhëheqësve të rinj ushtarakë veçse ka nxitur rritjen e çmimeve të ushqimeve dhe produkteve të tjera. Veçanërisht shqetësuese, sipas tij, janë edhe sanksionet që aktualisht nuk kanë përjashtime për çështje humanitare. Kjo, sipas Gignac, mund të çojë në mungesë të madhe të ushqimeve dhe ndihmës tjetër të nevojshme. Edhe pse ndikimi i plotë i sanksioneve ende nuk po ndihet,

Gignac paralajmëroi se pas një kohe "nëse ato nuk hiqen... ne nuk do të jemi në gjendje të dërgojmë ndihmën e duhur humanitare, gjë që mund të ketë ndikime katastrofike". UNHCR tha se afër 350.000 banorë të Nigerit veçse janë zhvendosur brenda vendit. Kjo agjenci e OKB-së tha se deri më tani nuk ka raportime për lëvizje të mëdha të popullatës nga Nigeri në shtetet fqinje.

Uragani i fuqishëm Idalia arrin në Floridë

TALLAHASSEE, 30 GUSHT - Uragani Idalia ka arritur në Florida të Shteteve të Bashkuara, stuhi që po konsiderohet "jashtëzakonisht e rrezikshme". Miliona persona veçse janë evakuuar ose po qëndrojnë në shtëpi dhe strehimore për shkak të stuhisë. Qendra Kombëtare e

Uraganeve në ShBA (NHC) tha se Idalia goditi plazhin Kiton në rajonin Big Bend të Floridës. Stuhia është vlerësuar se është e kategorisë tre dhe konsiderohet e rrezikshme për jetë. Uragani Idalia ka shkaktuar erëra deri në 201 kilometra në orë. Banorët e Floridës që jetojnë

përgjatë vijës bregdetare janë urdhëruar që të largohen, pasi Idalia fitoi fuqi duke kaluar përmes ujërave të ngrohtë të Gjirit të Meksikës. "Kjo stuhi është e fuqishme. Nëse jeni brenda shtëpive, qëndroni të sigurt derisa stuhia të kalojë", porositi guvernatori i Floridës, Ron DeSantis.



BE-ja: Kosova dhe Serbia t'i krijojnë kushtet për vazhdimin e dialogut

PRISHTINË, 30 GUSHT - Bashkimi Evropian (BE) i ka përsëritur kërkesat ndaj Kosovës dhe Serbisë për ndërmarrjen e hapave që u është kërkuar atyre për t'i krijuar kushtet për vazhdimin e dialogut, por nuk ka dashur të përmendë afate kohore se kur mund të ndodhë një takim i nivelit të lartë në Bruksel.

Këto qëndrime i ka shprehur për Radion Evropa e Lirë Peter Stano, zëdhënës i BE-së për çështje të jashtme dhe të sigurisë. "Puna në dialog po vazhdon. Ne e kemi përsëritur vazhdimisht javëve të fundit se ka një pritje të qartë nga ana e BE-së që palët t'i ndërmarrin hapat e definuar shumë qartë për deeskalim, dhe t'i krijojnë kushtet për vazhdimin e dialogut", tha Stano.

Më 10 korrik, Kosova dhe Bashkimi Evropian u pajtuan për disa hapa për shtensionimin e situatës në veri të Kosovës, përfshirë zvogëlimin e pranisë policore dhe organizimin e zgjedhjeve të reja në katër komunat veriore.

Policia e Kosovës njoftoi më 4 gusht për zvogëlimin për 25 për qind të prezencës së oficerëve të vet në dhe rreth objekteve komunale në veri të Kosovës.

Ndërkohë, i dërguari i posaçëm i BE-së për dialog Miroslav Lajçak, po i vazhdon takimet me përfaqësues të Kosovës dhe Serbisë për të përgatitur takimin e



radhës në kuadër të dialogut. Ai e ka përmendur muajin shtatorë si afat kur mund të ndodhë takimi i radhës, por jo edhe ndonjë datë të saktë.

Stano, po ashtu, ka refuzuar të përmendë data duke thënë se "do të shpallim datën për çfarëdo takimi të radhës të udhëhequr nga Përfaqësuesi i lartë kur të jetë

e përshtatshme".

Zëdhënësi i Bashkimit Evropian ka përsëritur edhe thirrjet për implementimin e shpejtë dhe pa vonesa të marrëveshjeve që kanë dalë nga dialogu. "Ne, po ashtu, kemi thënë shumë qartë se është e domosdoshme që dialogu i lehtësuar nga përfaqësuesi i lartë dhe implementimi i shpejtë i

marrëveshjes për normalizimin e raporteve dhe aneksit për implementim, të bëhen pa ndonjë vonesë të re" theksoi ai. Për një periudhë të gjatë nuk ka pasur takime në nivelin e lartë në kuadër të dialogut.

Herën e fundit kur Kryeministri i Kosovës Albin Kurti dhe Presidenti i Serbisë Aleksandër

Vuçiq ishin në Bruksel ishte 22 qershori, por as atëherë ata nuk patën takim mes vete.

Në BE pohojnë se synojnë që tash situatë të normalizohet në veri dhe që palët të evitohet çdo veprim i cili mund të shkaktojë tensione të reja dhe në këtë mënyrë të ndikojë negativisht edhe në procesin e dialogut.

Osmani: Pezullimi i vendimit për viza e vret dialogun

"Epoka e re"

PRISHTINË, 30 GUSHT - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë të mërkurën se pezullimi i vendimit për heqje të vizave për qytetarët e Kosovës nga 1 janari i vitit 2024, do ta vriste dialogun mes Kosovës dhe Serbisë.

Ajo i ka bërë këto deklarata, duke iu referuar qëndrimit të presidentit francez, Emmanuel Macron, i cili ka thënë më 28 gusht se vendi i tij do t'i rishikojë zotimet që i ka bërë për çështje ekonomike dhe politike të vizave për Kosovën dhe Serbinë, nëse ato nuk sillen me përgjegjësi. "Unë do të thosha që kjo është mënyra për ta vrarë dialogun një herë e përgjithmonë. Në qoftë se dëshiron dikush që të mos ketë më dialog, atëherë ndërmerr masa të tilla, që janë masa ndëshkuese ndaj popullit të Kosovës. Nuk janë ndaj ndonjë lideri, nuk janë ndaj një politike, janë ndaj popullit të Kosovës. Dhe një ndëshkim i tillë i paprecedentë, që edhe ashtu ka qenë padrejtësi e madhe për popullin e Kosovës, do të rezultojë me vdekjen e dialogut.



Nuk ka më askush mandat që të shkojë në Bruksel, kur populli i Kosovës ndëshkohet", ka thënë Osmani në një vizite të Memorialit për të Pagjeturit në Prishtinë.

Osmani ka thënë se Kosova ka arritur pajtueshmëri me Bashkimin Evropian për shtensionim të situatës në veri qysh më 10 korrik në Bratislavë. Ajo e ka përmendur që

marrëveshja parasheh zvogëlimin e pranisë së Policisë së Kosovës në dhe rreth ndërtesave komunale në veri, hap që ajo ka thënë se Kosova e ka bërë, dhe se është duke u

punuar në organizimin e zgjedhjeve të reja.

Sipas Osmanit, baza ligjore për mbajtje të këtyre zgjedhjeve do të jetë gati më 1 shtator, dhe kështu ka thënë se pret që BE-ja t'i heqë masat ndëshkuese ndaj Kosovës, të cilat ajo i ka vlerësuar si të padrejta dhe joproporcionale.

Një tjetër pikë e marrëveshjes së Bratislavës parasheh edhe kthimin sa më të shpejtë në dialog në nivel të lartë mes Kosovës dhe Serbisë.

Osmani ka thënë se pret lëvizje në këtë drejtim në shtator.

Për dialogun kanë diskutuar më 28 gusht edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti me të dërguarin e BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak.

Tensionet mes Kosovës dhe Serbisë kanë qenë të larta në maj të këtij viti, meqë banorët e komunave veriore - Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok - e kanë kundërshtuar hyrjen e kryetarëve të rinj shqiptarë në ndërtesat komunale.

Banorët e këtyre komunave me shumicë serbe kanë protestuar me javë para ndërtesave dhe me raste situata është përshkallëzuar në dhunë.



SHËNOHET DITA NDËRKOMBËTARE E PERSONAVE TË ZHDUKUR ME DHUNË

Kosova kërkon nga ndërkombëtarët t'i bëhet trysni Serbisë për të zhdukurit me dhunë

Me rastin e 30 gushtit, Ditës Ndërkombëtare të të Zhdurve me Dhunë, presidentja Vjosa Osmani së bashku me kryeparlamentarin Glauk Konjufca, kanë bërë homazhe dhe vendosur lule pranë memorialit përkujtimor dedikuar të zhdurve me dhunë gjatë luftës në Kosovë. Osmani ka thënë se Serbia po vazhdon ta përsërisë krimin e saj duke e fshehur vendndodhjen e personave të zhdurur me dhunë gjatë luftës së viteve 1998-1999 në Kosovë. Ndërkaq Konjufca i ka bërë thirrje bashkësisë evropiane dhe faktorëve të tjerë vendimmarrës që të bëjnë trysni te institucionet në Serbi që të zbardhet e vërteta për mijëra të zhdurur, për të cilët është përgjegjës shteti serb

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 30 GUSHT - Me rastin e 30 gushtit, Ditës Ndërkombëtare të të Zhdurve me Dhunë, presidentja Vjosa Osmani së bashku me kryeparlamentarin Glauk Konjufca, kanë bërë homazhe dhe vendosur lule pranë memorialit përkujtimor dedikuar të zhdurve me dhunë gjatë luftës në Kosovë. Osmani ka bërë thirrje të mërkurën që vendit të saj të mos i bëhet më trysni në dialogun e ndërmjetësuar nga Brukseli, derisa presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, të vazhdojë "të flejë mbi varrezat masive" të të pagjeturve nga

lufta e fundit në Kosovë.

Duke folur pas homazheve te Memoriali për të Pagjeturit më 30 gusht në Prishtinë, Osmani ka thënë se Serbia po vazhdon ta përsërisë krimin e saj duke e fshehur vendndodhjen e personave të zhdurur me dhunë gjatë luftës së viteve 1998-1999 në Kosovë. "Shpresojmë që dialogu në Bruksel nuk do të jetë më një proces përmes të cilit Kosovës do t'i bëhet trysni dhe popullit të Kosovës padrejtësi, ndërkaq fytyra e Vuçiqit, një njeriu që ende fle mbi varreza masive, do të vazhdojë të shpërlahet padrejtësisht. Në Ditën Ndërkombëtare të të Zhdurve qëndrojmë së

bashku në solidaritet me familjet e të zhdurve me dhunë dhe riafirmojmë përkushtimin tonë të vazhdueshëm për ta adresuar vazhdimisht këtë çështje derisa të zbardhet fati i secilit të zhdurur. Ata presin familjarët e tyre, ne presim qytetarët tanë! Nuk do të reshtim kurrë deri në zbardhjen e fatit të secilit! Serbia akoma fle mbi varreza masive. Udhëheqësit e këtij shteti që akoma nuk është ballafaquar me të kaluarën, kanë obligim t'i hapin arkivat!", ka thënë Osmani. Ndërkaq Konjufca ka thënë se zhdurja me dhunë e mijëra qytetarëve të Kosovës është një dhimbje që nuk po përfundon

kurrë dhe një mungesë e drejtësisë për familjarët dhe për të gjithë popullin e Kosovës, për të cilën përgjegjës është shteti serb. "Me vet faktin që në vitet e fundit në shumë lokacione të Serbisë, si në Peruçac, Rudnicë, Kizhevak dhe vende tjera u gjenden trupat e më të dashurve tanë, tregon që harta ku bashkësia ndërkombëtare duhet t'i kërkojë të zhdururit me dhunë është Serbia, e po ashtu Serbia është edhe shteti ku ndodhen kriminelët, të cilët i kanë kryer këto krime", tha kryetari Konjufca.

Kreu i Kuvendit ftoi bashkësinë evropiane dhe faktorë të tjerë vendimmarrës që të bëjnë trysni te institucionet në Serbi që të zbardhet e vërteta për mijëra të zhdurur, për të cilët është përgjegjës shteti serb. "Ne duhet t'i marrim të gjitha masat të cilat janë në dorën e institucioneve të Kosovës, ashtu që të sigurohemi se edhe bashkësia evropiane edhe faktorë tjerë të rëndësishëm të vendimmarrjes të vetëdijesohen se ka nevojë për një trysni më të madhe në Aleksandër Vuçiqin dhe institucionet e Serbisë, që t'i hapin arkivat e tyre dhe të zbardhet e vërteta për mijëra të

zhdurur, për të cilët përgjegjëse padyshim ka qenë ushtria, policia dhe formacionet paramilitare, të cilat janë kontrolluar totalisht nga shteti i Serbisë", tha kryetari i Kuvendit të Kosovës.

Pranë memorialit për të zhdururit me dhunë homazhe kanë bërë edhe anëtarë të kabinetit qeveritar dhe familjarë të personave të zhdurur.

E kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, përmes një postimi në "Facebook" bëri thirrje partnerëve ndërkombëtarë që ta rrisin presionin mbi Serbinë, duke shtuar se ajo është përgjegjëse për zhdurjen e qytetarëve të Kosovës. "Varret e hapura në Kosovë presin të vërtetën. Pesha e mungesës rëndon mbi familjet e 1617 personave të zhdurur me dhunë gjatë luftës në Kosovë. Nën presin ditën kur do të vendosin nga një lule në kujtim të më të dashurve të tyre. Atyre që u rrëmbyen e zhdurën me dhunë nga autoritetet e Serbisë urdhërdhënëse dhe ekzekutore. Pas rënies së Millosheviqit, në Serbi u zbuluan pesë varreza të mëdha masive, me gjithsej 950 njerëz tonë të rrëmbyer e të vrarë, të vrarë e të rrëmbyer, në

Blerja e librave, Nagavci: Prindërit të mos i blejnë pa pranuar listën nga ana e mësimitdhënësve

PRISHTINË, 30 GUSHT - Çështja e furnizimit të nxënësve me tekste shkollore këtë vit ka ngjallur reagime të shumta, pas vendimit të MASHTI-t që mjetet për blerjen e teksteve tu barten në llogaritë e prindërve.

Lidhur me gjithë zhurmën e krijuar rreth kësaj situatë, ministrja e Arsimit, Arbërie Nagavci në një intervistë në "Përballje" në Telegrafi.com me kryeredaktorin Muhamet Hajrullahu, ka sqaruar se përse MASHTI mori këtë vendim.

Ajo ka thënë se vendimi është marrë në mënyrë që buxheti i shtetit të mos keqpërdoret. "Në vend se mbi 10 milionë euro sa pritet të kushtojnë tekste, t'u barten në llogaritë e 5-6 shtëpive botuese të barten në llogaritë e më shumë se 200 mijë prindërve. Vendimin e kemi marrë në mënyrë që të sigurohemi që buxheti i shtetit të menaxhohet në mënyrë më të mirë të mundshme", tha Nagavci.

Ministrja shtoi se nxënësve nga klasa e 1 deri 5 do t'u ndahen nga 80 euro, (50 për tekste dhe 30 për mjetet mësimore), ndërkaq shumën prej 30 eurove do ta marrin edhe nxënësit e klasave 6 deri 9.

Nagavci shtoi se gjatë këtyre dy viteve sa janë në drejtim të

MASHTI-t kanë parë që ka pasur sfida të shumta, mundësi për abuzime dhe keqpërdorime. "Kemi adresuar disa lëndë në Prokurori, kemi pasur raste kur një tekst kushton 17 euro e më shumë. Kemi pasur raste kur i njëjti tekst të së njëjtës klasë, shembull matematika e klasës së dytë ku një tekst ka pas 7.29 euro, 8.10 euro, 9.05 euro dhe 14.00 euro. Ka pasur raste kur një tekst në një vit na është shitur me çmimin 3 euro e vitin tjetër 14 euro", u shpreh ministrja në "Përballje" në Telegrafi.com.

Më tej ministrja Nagavci bëri të ditur se do të kujdesen që ekzekutimi i parave në llogaritë e prindërve të bëhet para datës 1 shtator. "Deri më tani kemi më shumë se 80 mijë aplikime i kemi marrë listat me të gjitha dhënat e aplikuesve nga ASHI-ja dhe besoj që gjatë ditës do ti përcjellim të gjitha në Ministrinë e Financave në mënyrë që të sigurohemi që ekzekutimi i mjeteve të bëhet para datës 1 shtator", tha ajo.

E para e MASHTI-t pati edhe një apel për prindërit që të mos nxitohen me blerjen e teksteve shkollore pa pranuar listën e tyre na ana e mësimitdhënësve ose shkollave. "Secili prej prindërve duhet të marrë listën me tekste që duhet të përdoren nga ana e



shkollave dhe mësimitdhënësve. Ne kemi dërguar në drejtoritë komunale të arsimit një qarkore që kemi kërkuar që lista e teksteve të miratuara të bëhet publike në vendet e dukshme të shkollës, dhe mësimitdhënësit ti ndajnë informatat me prindërit", tha Nagavci.

Ajo shtoi se kanë pranuar informata që në shumicën e shkollave menaxhmenti i shkollave ka kërkuar nga secili mësimitdhënës që të bëjë listën me tekste dhe mjetet tjera mësimore për të cilat fëmijët duhet të jenë të

pajisur për të vijuar mësimin e rregullt.

Se a do të mjaftojnë 80 euro për blerjen e teksteve mësimore për nxënësit e klasave 1-5, ministrja u shpreh se po dhe se çmimi është caktuar në bazë të çmimit që kanë pasur tekste vitin e kaluar dhe çmimit që kanë negociuar këtë vit me shtëpitë botuese. "Në bazë të shënimeve të çmimeve të vitit të kaluar dhe në bazë të negociatave që janë bërë këtë vit për furnizim me tekste kemi caktuar edhe shumën, dhe në takimet që zyrtarët e ministrisë kanë pasur

me shtëpitë botuese ju kanë kërkuar që të mos rriten çmimet në këtë kohë dhe ka pasur zotim nga ana e tyre se kemi tekste të mjaftueshme dhe se çmimet nuk do të rriten. Po ne besojmë që do të mjaftojnë paratë që i marrin për tu pajisur me tekste mësimore", tha Nagavci.

Ministrja shtoi se çdo rritje e çmimit çdo abuzim do ta adresojnë tek Autoriteti i Konkurrencës. Ndryshe ajo në këtë intervistë ka folur edhe për kritikën e opozitës dhe SBASHK-ut.

Batajnicë, Peruqac, Petrovo Selo, Rudnicë e Kizhevack. Serbia ende vazhdon të qëndrojë mbi varre masive teksa i mohon ato. Sot e gjithnjë u bëj thirrje partnerëve ndërkombëtarë që ta rrisin presionin mbi Serbinë, si përgjegjëse për zhdukjen e qytetarëve tonë, për të zbardhur fatin e tyre dhe për të vënë drejtësi duke dënuar përgjegjësit politikë ushtarakë e policorë për këto krime", ka shkruar Kurti.

Ai ka kërkuar që të sillen para drejtësisë dhe të dënohen përgjegjësit politikë ushtarakë e policorë për këto krime. "Si zotim i yni ndaj kujtesës sonë si popull dhe ndaj kërkesës sonë për drejtësi, po themelojmë Institutin për krimet e kryera

gjatë luftës në Kosovë. Me ndryshimet që kemi bërë në legjislacionin përkatës, institucionet tona të drejtësisë mund të ndjekin dhe të dënojnë kryerësit e krimeve të luftës në mungesë, kudo që ata janë", ka shkruar kryeministri Kurti.

Edhe përfaqësuesit e opozitës kanë shkruar për Ditën Ndërkombëtare të Zhdukurve me Dhunë. "Në Ditën Ndërkombëtare të Personave të Zhdukur, nderojmë kujtimin për të gjithë të zhdukurit me dhunë gjatë luftës së fundit në Kosovë, fati i të cilëve mbetet ende i pazbardhur. Prapa secilit prej tyre, qëndrojnë familjet që mbi dy dekada jetojnë me dhembjen dhe ankthin e mosnjohjes së të vërtetës për



ta", ka shkruar në "Facebook" lideri i PDK-së, Memli Krasniqi, duke theksuar se institucionet e vendit duhet të angazhohen më shumë për zgjidhjen e fatit të të gjithë personave të zhdukur, si dhe institucionet ndërkombëtare duhet të shtojnë presionin mbi Serbinë për hapjen e arkivave, si dhe sa më shpejtë të vënë para drejtësisë kriminelët e luftës që kanë qenë përgjegjës për zhdukjen e tyre. Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se sot kur e gjithë bota kujton personat e zhdukur, zemra jonë rrah me

familjarët që ende presin me ankth për fatin e të dashurve të tyre. "Motrat, vëllezërit e fëmijët tanë të pagjetur mbesin plagë e hapur, dhembje që vazhdon. Qëndrojmë të palëkundur, për të kërkuar të vërtetën dhe drejtësinë e munguar!", ka shkruar në "Facebook" Haradinaj.

Në Ditën Ndërkombëtare të personave të zhdukur, edhe kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka bërë thirrje që të ndriçohet një herë e përgjithmonë fati i mbi 1600 qytetarëve tanë, të

zhdukur tash e mbi dy dekada. "Nuk duhet të ndalemi asnjëherë së kërkuari drejtësi dhe zbardhjen e fatit të të gjithë të zhdukurve. Kjo plagë e cila është ndër më të rëndat që ka shkaktuar lufta vazhdon të rëndoj mbi familjet e personave të zhdukur, shoqërinë dhe vendin tonë në përgjithësi", ka thënë Limaj.

Më 30 gusht shënohet Dita Ndërkombëtare e Viktimave të Zhdukjeve me Forcë.

Të zhdukur, edhe sot e kësaj dite, mbeten ende mbi 1,600 persona.



Në oborrin e Presidencës së Kosovës mbillet bredhi dedikuar Nënë Terezës

PRISHTINË, 30 GUSHT - Presidentja Vjosa Osmani, në kuadër të manifestimit tradicional "Ditët e Nënë Terezës", bashkë me drejtorin e Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve-Shkup, Skënder Asani dhe biografin e Nënës Terezë, Dom Lush Gjergji, të mërkurën në oborrin e Presidencës së Kosovës, në kujtim të Shën Terezës, mbollën bredhin me farat e

bredhit të shkatërruar të Nënë Terezës. "Ky bredh, i mbjellë sot, simbolizon dëshminë e veprës së Nënë Terezës në shërbim të njerëzimit, vullnetin e saj për t'i shërbyer atij. Nënë Tereza gjeti gjithmonë forcë që dhimbjen e saj, të popullit të saj dhe të gjithë të vuajturve ta kthejë në dashuri për njerëzimin, në vepër të përvuajtur në shërbim të të varfërve, madje, sikur thoshte vetë, në

shërbim të më të varfërve ndër të varfrit", ka thënë presidentja Osmani Ndërkaq, drejtori i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve-Shkup, Skënder Asani, ka thënë se bredhi dedikuar Nënë Terezës simbolizon lidhjen mes njerëzve, popujve e vendeve. "Shembulli i saj në shërbim të njerëzimit është modeli më i vyer, të cilin ne mund ta njohim", ka thënë Asani.



Klinaku intervistohet nga policia pas deklaratës se do ta vriste Kurtin

PRISHTINË, 30 GUSHT - Ushtruesi i detyrës së kryetarit të OVLUÇK-së, Faton Klinaku është intervistuar të mërkurën nga policia, për deklaratën që bëri një ditë më parë për kryeministrin Albin Kurti, me ç'rast tha se më parë do ta vriste atë, sesa ta lëshonte Kosovën.

Pas intervistimit, Klinaku bëri me dije se kjo deklaratë e tij është nxjerrë nga konteksti. Teksa theksoi se nuk e ka në plan të japë dorëheqje, pavarësisht kërkesave që po i bëhen. "Sapo dola nga stacioni policor. Me urdhër të prokurorit u intervistova lidhur me deklaratën. Siç e thashë edhe në polici, ajo deklaratë është nxjerrë prej konteksti. Kaq mund të them për media. E sa i përket kërkesave për dorëheqjen time nga drejtimi i



OVLUÇK-së, hiç në plan nuk e kam. Nuk më kanë zgjedhur

ata që po kërkojnë dorëheqjen time, por anëtarët e

organizatës së veteranëve", ka thënë Klinaku.

Ushtruesi i detyrës së kryetarit të OVLUÇK-së të martën ka ndarë në rrjetin social në "Facebook" një bisedë që ka pasur me një votues të Kurtit, ku ndër të tjerash ka thënë se "më parë e vras Albin Kurtin sesa që ia lëshoj rrugën e iku nga Kosova". "Aq shumë i dëshpëruar votuesi i tij saqë tha: Votën ia dhashë për ndryshim, e ndryshim lëre që nuk ka por po shkojmë edhe më shumë teposhtë si vend dhe s'ka mbetur tjetër gjë pos me ikë jashtë. I thashë: As se kam votu, as ndryshim për të mirë kurrësi që nuk kam pritur nga ai, e sa i përket daljes jashtë, më parë e vras Albin Kurtin sesa që ia lëshoj rrugën e iku nga Kosova. PS Kosovën nuk duhet, e as që guxojnë ta lëshojnë ata që kanë luftuar për të", kishte shkruar në "Facebook" Klinaku.

Konjufca: Kur bllokohet parlamenti, nuk bllokohet LV-ja e as Kurti por republika



PRISHTINË, 30 GUSHT - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka thënë se bllokimi i seancave nga opozita do të jetë në dëm të republikës. Për këtë, kryeparlamentari ka kërkuar që mos të ketë bllokada.

Kreu i Kuvendit ka thënë të mërkurën se në sesionin vjeshtor pret që seancat të mbahen siç ka thënë në formën normale.

Ai ka theksuar se bllokimi i seancave në sesionin vjeshtor nuk do ta dëmtojë

mazhorancën e as kryeministrin Albin Kurti por vetë Republikën e Kosovës. "Shpresoj që nuk do të ketë bllokim të seancave. Jam optimist se Kuvendi do të mund të punojë në formën e vetë normale dhe do të krijohen kushtet për punë, sepse kjo është le të themi parakusht demokratik i shtetit tonë. Nëse parlamenti bllokohet atëherë bllokohet vetë shteti. Me bllokimin e parlamentit nuk e keni bllokuar mazhorancën, me bllokimin e parlamentit bllokohet

republika. Pra nuk bllokohet Albin Kurti as Vetëvendosja e as mazhoranca. Së pari bllokohet Kosova, shteti i Kosovës, dhe kjo do të ishte dëm i madh. Mendoj që as opozita nuk e ka këtë qëllim", ka thënë Konjufca. Ndërkaq i pyetur për iniciativën e opozitës për rrëzim të qeverisë, Konjufca dha një përgjigje interesante para gazetarëve. "Qeveria Kurti në shtëpi është, pra është në shtëpinë e vetë. Këtu është shtëpia e qeverisë, prapa teje", ka deklaruar Konjufca.

Haradinaj uron Turqinë dhe popullin e saj me rastin e Ditës së Fitores

PRISHTINË, 30 GUSHT - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka marrë pjesë në shënimin e Ditës së Fitores së Republikës së Turqisë. Haradinaj me këtë rast ka thënë se jemi gjithmonë falënderues për mbështetjen e vazhdueshme që Turqia i ka

dhënë Kosovës. "Pata kënaqësinë që me ftesë të ambasadorit turk në Kosovë, z. Sabri Tunç Angılı, të marr pjesë në shënimin e Ditës së Fitores së Republikës së Turqisë, me dëshirën për prosperitet dhe paqe për popullin dhe shtetin turk", ka thënë Haradinaj. Ai ka shtuar se Kosova është

falënderuese për mbështetjen e Turqisë në të gjitha periudhat e shtetndërtimit. "Jemi gjithmonë falënderues për mbështetjen e vazhdueshme që Turqia i ka dhënë Kosovës dhe popullit të saj në të gjitha periudhat e shtetndërtimit", është shprehur Haradinaj.



Nënshkruhet marrëveshja për ndërtimin e QKMF-së në vlerë mbi 2 milionë euro në Ferizaj

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 30 GUSHT - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia dhe kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu kanë nënshkruar plotësimin ndryshimin e memorandumit të bashkëpunimit për ndërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Komunën e Ferizajt. Ministri Vitia ka theksuar se ndërtimi i QKMF-së është në funksion të një infrastrukture moderne me synimin që të ofrojë shërbime sa më cilësore për qytetarët e Komunës së Ferizajt. "Ngaqë në të kaluarën janë identifikuar probleme serioze në zbatimin e kontratës gjatë ndërtimit të spitalit të Ferizajt, bashkërisht si institucione jemi angazhuar që mos të përsëriten pengesat teknike në rastin e ndërtimit të QKMF-së. Sot jam i lumtur që nënshkruam plotësimin ndryshimin e marrëveshjes e cila qytetarëve të Ferizajt do t'ua bëjë

të mundur në të ardhmen marrjen e shërbimeve shëndetësore në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare që është një projekt jashtëzakonisht i rëndësishëm për ta. Jemi siguruar që ky projekt në vlerë të 2 milion e 250 mijë euro, të realizohet pa vonesa dhe janë saktësuar përgjegjësitë e palëve", ka thënë Vitia.

Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, falënderoi ministrin Vitia për bashkëpunimin dhe përkrahjen veçanërisht pasi që regjioni i Ferizajt ofron shërbime për një numër të madh të popullatës, duke përfshirë edhe komunat tjera përreth.

Vlera totale e ndërtimit të QKMF-së në Komunën e Ferizajt është 2 milionë e 250 mijë euro.

Ministria e Shëndetësisë do të ndajë për këtë projekt 2 milionë e 25 mijë euro (90%), ndërsa Komuna e Ferizajt do të participojë me 225 mijë euro apo 10% të vlerës totale, si dhe merr përsipër koston shtesë në rast të tejkalimit të buxhetit të planifikuar.



Pacientët nuk u trajtuan në mënyrë të barabartë dhe efektive nga Fondi për Sigurime Shëndetësore

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 30 GUSHT - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka publikuar raportin e auditimit të performancës "Efektiviteti i Programit për Trajtimin e Pacientëve Jashtë Institucioneve Shëndetësore" për periudhën 2019-2022.

Konkluzioni i këtij auditimi është se Fondi për Sigurime Shëndetësore (FSSH) së bashku me Bordin Ekzekutiv nuk ishin efektiv në procesin e menaxhimit të subvencionimit të pacientëve për trajtim jashtë institucioneve shëndetësore publike.

Rezultatet e auditimit tregojnë se pacientët nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë që nga procesi i aplikimit e deri te aprovimi i kërkesave.

FSSH-ja përdori praktika të ndryshme në vlerësimin dhe trajtimin e lëndëve që nga aplikimi i kriterëve të ndryshme për rastet e njëjta e deri te shumica e aprovuar për trajtim. Aprovimi i lëndëve dhe pagesave është përcjellë me vonesa, obligimet financiare nuk ishin menaxhuar dhe raportuar në mënyrë të duhur si dhe Fondi nuk kishte bërë të gjitha barazimet financiare me institucionet shëndetësore në të cilat janë parapaguar shërbimet. Bordi Ekzekutiv kishte aprovuar



lëndë në mungesë të dy profaturave dhe nuk ishte konsistent në shumatat që kishte ndarë për mbulim të trajtimit duke mos respektuar kriteret e Udhëzuesit Administrativ.

Me aprovim të Bordit, Fondi pagoi 756,142 euro për raste diagnozat e të cilëve nuk janë paraparë në Udhëzues Administrativ. Mirëpo, disa raste u refuzuan pikërisht me arsyetimin

se diagnozat nuk janë pjesë e Udhëzuesit.

Pavarësisht se Programi është i destinuar të financojë trajtimin e pacientëve me diagnoza, sëmundjet e të cilave nuk trajtohen në Institucionet Shëndetësore Publike të Kosovës, Komisionet Konziliare në reparte të caktuara kishin referuar kërkesa për shërbimet që ofrohen brenda këtyre institucioneve me

arsyetimet për mungesë të materialit, kushteve teknike dhe resurseve njerëzore. Për këto raste shumica e referuar dhe aprovuar nga mostrat e testuara ishte 844,779 euro.

Fondi nuk menaxhoi dhe nuk raportoi në mënyrë të duhur obligimet, kishte vonesa në aprovim dhe pagesa, madje kishte fatura që nuk janë paguar që nga 2018. Fondi nuk ka pasqyrë të saktë

të kostove reale dhe mjeteve të lira të mundshme, barazimet janë bërë vetëm me spitalet në Kosovë dhe disa në rajon, por jo edhe me spitalet e tjera. Nga 12 milionë euro të aprovuara për rastet e rregullta, komisioni kishte arritur të barazojë vetëm 2,1 milionë apo 16,4% si dhe kishte identifikuar mbi 408 mijë euro mjete të lira.

Mangësitë e identifikuar në procesin e menaxhimit të subvencionimit të pacientëve për trajtim jashtë institucioneve shëndetësore publike ishin pasojë e ndryshimeve të praktikave të menaxhimit të këtij programi, pa u arsyetuar nevojat për ndryshim, mos funksionimi i duhur i kontrolleve të brendshme, ndryshimet e vazhdueshme organizative si dhe mos qartësimi i kornizës ligjore.

Lidhur me këtë auditim, Auditorja e Përgjithshme, Vlora Spanca, ka deklaruar se trajtimi jo i barabartë i pacientëve, ndryshimet e paarsyetuara të kriterëve dhe shumave të aprovuara për trajtim, vonesat në aprovim dhe pagesë, si dhe mos menaxhimi i duhur i obligimeve financiare, rrezikon që Programi të mos arrijë objektivat për të cilat është themeluar.

Për të siguruar që Programi për Trajtimin e Pacientëve Jashtë Institucioneve Shëndetësore menaxhohet në mënyrë më efektive dhe arrin objektivat, ZKA-ja dha 13 rekomandime.

Ministria e Bujqësisë ndan 24.6 milionë euro për Programin për Zhvillim Rural 2023

PRISHTINË, 30 GUSHT - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, ka bërë me dije se ka nënshkruar Programin për Zhvillim Rural / Grante 2023 në vlerë prej 24,6 milionë euro. "Përmes Programit për Zhvillim Rural / Grante 2023 kemi: Rritje të mbështetjes për prodhimin bazik bujqësor, specifikisht karshi rritjes së konsiderueshme të Fondit Blegtoral me qëllim të shtimit të prodhimit të qumështit dhe mishit; me 5 milionë euro (Masa 1, Nënmasa 1.7); Kemi eliminuar kriteret

diskriminuese; Do të ketë rritje të mbikëqyrjes përgjatë të gjithë procesit me qëllim të mbrojtjes të së drejtës së aplikimit dhe qasjes së barabartë të të gjithë qytetarëve të Kosovës që me të vërtetë ushtrojnë veprimtari bujqësore, janë fermerë meritorë e mbi të gjitha real", ka thënë Peci.

Ai ka treguar se 16,827,000.00 euro apo 68,33 për qind e buxhetit të granteve i kushtohen Masës 1 - Investime në asete fizike dhe ekonomitë familjare. Sipas Pecit, kjo masë përfshin

prodhimin bazik bujqësor. "3,500,000.00 euro apo 14,21 për qind e po këtij buxheti i dedikohet Masës 3 - për Investime në asete fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore. 4,000,000.00 euro apo 16,24 për qind e buxhetit të PZHR 2023 i kushtohet Masës 7 - për Diversifikimin e Fermave dhe Zhvillimin e Bizneseve. 300,000.00 apo 1,22 për qind e buxhetit i kushtohet Masës 5 për Zbatimin e Strategjive për Zhvillim Lokal - Qasja 'Leader'", ka bërë me dije ministri Peci.



Bankat amerikane rrisin kufirin e borxhit për 25 për qind për të zbutur pasojat e falimentimeve

PRISHTINË, 30 GUSHT - Bankat do të duhet të lëshojnë rreth 70 miliardë dollarë borxh të ri sipas një rregulli të ri të propozuar nga rregullatorët bankar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, pjesë e një përpjekjeje më të gjerë për të forcuar qëndrueshmërinë e sektorit pasi tre huadhënës falimentuan në fillim të këtij viti.

Propozimi i bërë nga Korporata Federale e Sigurimit të Depozitave, Rezerva Federale dhe Zyra e Kontrolluesit të Monedhave, do t'i sillte bankat me mbi 100 miliardë dollarë aktive më shumë në linjë me gjigantët më të mëdhenj të Wall Street, të cilët tashmë kanë kërkesa për borxhin e tyre.

Vendimi pason një pranverë të trazuar për bankat rajonale, në të cilën Silicon Valley Bank dhe dy huadhënës të tjerë falimentuan, duke i detyruar rregullatorët të ndalojnë depozitat për të shmangur një panik më të gjerë.

Korporata Federale e Sigurimit të Depozitave argumenton se kriza dëshmoi se bankat më të vogla kanë nevojë për rregulla më të repta dhe se kërkesa prej tyre për të emetuar më shumë borxhe afatgjatë do të



siguronte një zbutje më shumë për humbjet, do të siguronte depozituesit dhe do të inkurajonte investitorët që të shqyrtojnë nga afër operacionet e bankave.

Propozimi, që ka shkaktuar shumë reagime në sektorin e industrisë, do t'i shihte bankat

të rrisin emetimin e tyre afatgjatë të borxhit me afërsisht 25 për qind ose 70 miliardë dollarë. Korporata tha se bankat do të kenë tre vjet kohë nga miratimi i rregullit për të përmbushur standardin e ri. Nëse finalizohet, huadhënësit do të detyrohen të lëshojnë

borxhe në një mjedis ku normat e interesit janë rritur me shpejtësi dhe ndërsa rregullatorët po bëjnë njëkohësisht një propozim të veçantë, gjithëpërfshirës që do t'u kërkonte gjithashtu huadhënësve të rrisin ndjeshëm kapitalin e tyre.

Kërkesa për borxhin e secilës bankë do të bazohet në aktivet e saj të ponderuara me rrezikun, aktivet totale ose levën totale, në varësi të numrit më të lartë. Bankat rajonale janë ndër ato që do të ndjejnë më shumë pasojat e këtyre rregullave të reja më të ashpra.

Ismaili dhe Perani pajtohen për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet BQK-së dhe IFC-së

PRISHTINË, 30 GUSHT - Banka Qendrore e Kosovës (BQK) dhe Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC) janë pajtuar që ta thellojnë bashkëpunimin ndërmjet këtyre institucioneve.

Sipas njoftimit për medie, guvernatori i BQK-së, Ahmet Ismaili dhe drejtori i zyrës për Kosovë dhe Maqedoni e Veriut të IFC-së, Visar Perani kanë diskutuar që ta rrisin aktivitetin në fusha të ndryshme brenda mandatit të dy institucioneve.


"Në takim u diskutua për zgjerimin e bashkëpunimit në fusha të ndryshme brenda mandatit të dy institucioneve, duke përfshirë: qeverisjen kooperative, bashkëpunimin dhe përfaqësimin ndërkombëtar, financimin e projekteve në vend, pikëpamjet për draftin e ligjit për institucionet mikrofinanciare, gjithëpërfshirjen financiare dhe financimin e qëndrueshëm. Të dy palët u pajtuan që të thellojnë bashkëpunimin në çështjet e

diskutuara, me fokus në fushat prioritare në pajtim me objektivat e përbashkëta", ka njoftuar BQK-ja.

Në fund, guvernatori Ismaili shprehu mirënjohjen dhe falënderimin e BQK-së ndaj Peranit për bashkëpunimin dhe përkrahjen e vazhdueshme që Korporata Financiare Ndërkombëtare (pjesë e Grupit të Bankës Botërore) i ka ofruar BQK-së, sektorit financiar dhe ekonomisë së vendit.



Ekonomia e Kinës është si “minë me sahat”



Evergrande Group, gjiganti kinez i pasurive të paluajtshme po merr fund! Aksionet kanë rënë pothuajse 80% në ditën e parë të tregtimit në Hong Kong për një vit e gjysmë. Po ashtu kanë humbur më shumë se 99% të vlerës së tyre në tre vitet e fundit pasi Pekini goditi firmat e pronave. Evergrande është në qendër të një krize të tregut të pasurive të paluajtshme që kërcënon ekonominë e dytë më të madhe në botë. Të dielën, firma postoi një humbje prej 33 miliardë juanë (4.5 miliardë dollarë; 3.6 miliardë £) për gjashtë muajt e parë të vitit. Megjithatë, ky ishte një përmirësim ndaj humbjes prej 66.4 miliardë juanë që raportoi për të njëjtin periudhë të një viti më parë. Për vite, kompania me bazë në Shenzhen ishte një nga zhvilluesit më të mëdhenj të pronave në Kinë për nga shitjet. Por ajo kishte marrë shumë hua për të financuar zgjerimin e saj dhe kishte

dështuar në borxhin e saj në 2021, duke shkaktuar një krizë në sektorin e pasurive të paluajtshme të Kinës, i cili dikur përbënte deri në 30% të ekonomisë së vendit. Në fillim të këtij muaji, ajo aplikoi për falimentim në Shtetet e Bashkuara.

Kriza Evergrande

Këtë muaj, pagesat e munguara të kuponit në dollarë amerikanë nga zhvilluesi më i madh privat i Kinës, Country Garden (2007.HK), nxitën shqetësimin për ngjitjen në një ekonomi tashmë të dobësuar. Në një dosje të dielën, gjiganti kinez Evergrande tha se të ardhurat e gjysmës së parë u rritën 44% nga një vit më parë në 128.2 miliardë juanë, pasi “planifikonte në mënyrë aktive për rifillimin e shitjeve dhe kapi me sukses bumin e shkurtër të tregut të pronave që u shfaq në fillim të vitit”. Paratë

e gatshme ranë me 6.3% në 13.4 miliardë juanë. Detyrimet ranë pak në 2.39 trilion juanë nga 2.44 trilion juanë në fund të vitit 2022, ndërsa aktivet totale gjithashtu u tkurrën në 1.74 trilion juanë nga 1.84 trilion juanë. Zhvilluesi postoi një humbje neto të kombinuar prej 81 miliardë dollarësh për 2021 dhe 2022 në një raport të vonuar të të ardhurave muajin e kaluar, kundrejt një fitimi prej 8.1 miliardë juanë në 2020. Evergrande tha se aftësia e tij për të vazhduar do të varet nga një zbatim i suksesshëm i një plani të ristrukturimit të borxhit në det të hapur dhe negociata të suksesshme me pjesën tjetër të huadhënësve.

Bota në telashe

Hapi i ndërmarrë nga China Evergrande, i cili shpreson të kufizojë dëmin në këtë mënyrë, rrezikon të ndikojë përtej kufijve të dy vendeve. PBB-ja kineze është

ngadalësuar kohët e fundit dhe frika se problemet në sektorin kinez të pasurive të paluajtshme mund të përhapen në pjesë të tjera të ekonomisë së vendit është shtuar. Kjo do të shkaktonte një efekt domino në të gjitha vendet që kanë kanale tregtare dhe ekonomike me Kinën. Falimenti i China Evergrande pritet të pasohet kolapsin e një tjetër gjiganti të të njëjtit sektor, Country Garden, dikur kompania e dytë më e madhe e pasurive të paluajtshme në vend. Kreditë e njëkohshme të China Evergrande dhe Country Garden, si dhe kompanive të tjera më të vogla, e ka futur në krizë sektorin e pasurive të paluajtshme të Republikës Popullore. Country Garden ka filluar të japë shenjat e para të pamundësisë për të paguar këstet. Kriza në sektorin e pasurive të patundshme e bën të vështirë arritjen e objektivit për një rritje 5% të ekonomisë, sepse nuk do të kishte garanci mbijetese për ata që

ndërlidhen me botën e punës. Dhe si rezultat, bëhet problem edhe për pjesën tjetër të botës.

Alarmi i Biden

Javën e kaluar, presidenti amerikan Joe Biden e quajti Kinën një “bombë me sahat” pasi çmimet e konsumit ranë atje për herë të parë në dy vjet dhe bëri një paralajmërim ogurzi për potencialin që Kina të bëjë “gjëra të këqija” gjatë periudhave të vështira ekonomike. Paralajmërimi i Biden vjen në një kohë kur marrëdhëniet Kinë-SHBA kanë prekur një nivel shumë të ulët. Biden nuk specifikoi se çfarë donte të thoshte kur tha se Kina mund të bënte “gjëra të këqija”, por presidenti mund të ketë qenë duke iu referuar përshkallëzimit të tensioneve midis Kinës dhe Tajvanit. Disa analistë argumentojnë se Kina përdor nacionalizmin dhe konfrontimet e jashtme për të larguar vëmendjen nga problemet e saj të brendshme.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Invert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Tri klubet shqiptare kërkojnë fazën e grupeve në Ligën e Konferencës



EPOKA E RE
Veton ZYMBERI
PRISHTINË, 30 GUSHT - Tri klubet shqiptare pjesëmarrëse në Ligën e Konferencës i zhvillojnë ndeshjet kthyesë në "play-off" dhe kërkojnë kualifikimin në fazën e grupeve. Kampionia e Kosovës, Ballkani është shumë afër të arrijë këtë synim për faktin që arriti fitore me rezultat bindës 4-1 para një jave në ndeshjen e parë që u zhvillua në stadiumin "Fadil Vokrri". Djelmohat e drejtuar nga Ilir Daja duhet të ruajnë epërsinë e ndeshjes së parë dhe të kualifikohen për vitin e dytë radhazi

në këtë nivel garash, që normalisht është sukses i madh për klubin nga Suhareka dhe futbollin e Kosovës. Ballkani ka njoftuar që ekspedita e klubit ka mbërritur në Hungari dhe ka shfaqur optimizëm për suksesin e radhës në futbollin evropian. "Skuadra ka arritur në Hungari, ku të enjten e zhvillojmë ndeshjen më të rëndësishme të fazës eliminatorie në UEFA Conference League. Tashmë jemi përball sfidës kryesore, krejt forca dhe energjia jonë është e fokusuar në këtë duel, nga i cili me besim të plotë, shpresojmë të dalim faqebardhë. Na priftë e mbara", thuhet në njoftimin e kampionëve të

Kosovës. Ndryshe nga Ballkani më të vështirë e kanë Partizani dhe Struga. Klubi nga Shqipëria, Partizani ndeshjen e parë e humbi me rezultat minimal nga FC Astana (1-0) dhe tash synon të shfrytëzojë epërsinë e terrenit vendas dhe të arrijë kualifikimin e madh. Më të vështirë kualifikimin e ka skuadra shqiptare nga Maqedonia nga Veriut, Struga që do të përballlet me Breioablik. Struga e humbi ndeshjen e parë me rezultat 0-1 dhe tash i duhet ta përmbysë rezultatit për të arritur në fazën e grupeve, por duke parë cilësitë e skuadrës kundërshtarë një gjë e tillë nuk do të jetë aspak e lehtë.

SHKURT

Berisha edhe zyrtarisht pjesë e Empolit

Etrit Berisha është zyrtarisht lojtari më i ri i Empolit. Portieri i kombëtares shqiptare largohet nga Torino për të nisur një aventurë të re në Toskanë. Pas Lazio, Atalanta, Spal dhe Torino, Berisha do të mbrojë portën e Empolit në kampionatin italian. Tek Empoli gardiani kuqezi do të bashkohet me dy lojtarë të tjerë shqiptarë, Ismajlin dhe Shpendin.

Hasani, afër transferimit te klubi i njohur turk

Florent Hasani me shumë mundësi po kalon ditët e fundit si "bardheblu", pasi është në prag largimi nga Tirana. E ardhmja e Hasanit lidhet ngushtë me kampionatin turk dhe më konkretisht me një prej ekipeve të Stambollit, emri i të cilit ende nuk është bërë i ditur, por pritet që gjithçka të mbyllet deri ditën e enjte. Sezonin e shkuar Hasani ishte një nga lojtarët më të mirë të "bardhebluve", duke shënuar 19 gola në kampionat, Kupë dhe Superkupë. Në krahasim tjetër, largimi i "bomberit" lë një gropë të madhe në sulm, pasi duhen golat e tij që sezonin e shkuar çuan ekipin në majën e Superiores.

Januzaj mund të largohet nga Evropa

Adnan Januzaj mund ta përfundojë aventurën në futbollin evropian, për t'u transferuar në elitën e futbollit arab. Sipas gazetarit nga Belgjika, Sacha Tavolieri, për 28 vjeçarin ka shprehur interesim Al Tai nga Arabia Saudite. Januzaj që është lojtar i Sevilla nga gushti i vitit të kaluar, ka përjetuar periudhë të vështirë pasi për spanjollët ka zhvilluar vetëm 6 ndeshje, duke mos regjistruar gol dhe asist në 126 minutat me fanellën e andaluzianëve. Në shkurt të këtij viti u huazua tek Basaksehir në Turqi, duke shënuar dhe asistuar tre herë në 17 ndeshje, por me përfundimin e sezonit u kthye në Spanjë. Januzaj nuk është pjesë e planeve të trajnerit Jose Luis Mendilibar Etxebarria dhe për këtë arsye pritet të largohet këtë afat kalimtar.

SC Gjilani prezanton kryetarin dhe katër aksionarët e klubit

GJILAN, 30 GUSHT - Skuadra e Gjilanit ka ndryshuar tërësisht sa i përket kryesisë, pasi aksionarë të rinj kanë ardhur në krye të klubit nga

Anamorava. Pas largimit të ish-presidentit Florim Zuka, një grup i biznesmenëve të suksesshëm kryesisht që jetojnë dhe veprojnë në

diasporë kanë marrë drejtimin e klubit. Kryetari i klubit është zgjedhur Afrim Veliu, një gjilanas që jeton dhe vepron në Zurich të Zvicrës. Ndërkohë

pjesë e bordit të klubit do të jenë aksionarët e tjerë, Fatlum Pireva, Qëndrim Demiri, Valmir Emini dhe Shaban Bajrami.



Pensionet Admir Mehmedi

CYRIL, 30 GUSHT - Admir Mehmedi i ka dhënë fund karrierës së tij në moshën 32-vjeçare. Sulmuesi shqiptar nga Maqedonia e Veriut i rritur në Zvicër ka bërë një karrierë prej 15 vitesh në futbollin profesionist. Mehmedi e nisi te

Winterthuri duke kaluar nëpër të gjitha grupmoshat te kjo skuadër, për të vazhduar pastaj në Zvicër te FC Zurich. Ai për një vit e gjysmë qëndroi te Dynamo Kiev në Ukrainë, para se të transferohej në Bundesligën gjermane. Në

elitën e futbollit gjerman Mehmedi qëndroi plot tetë vite, duke veshur fanellat e skuadrave si Freiburg, Bayer Leverkusen dhe Wolfsburg. Krejt në fund sulmuesi shqiptar ishte pjesë e skuadrës turke Antalyaspor, derisa vendosi t'i

japë fund karrierës së tij. Mehmedi ka qenë pjesë e Përfaqësueses së Zvicrës nga U16 deri tek ekipi senior. Ai ka luajtur për Zvicrën A në 76 ndeshje ku ka realizuar edhe 10 gola dhe ka asistuar në shtatë të tjerë.



Trajneri i Zvicrës: Ndeshja ndaj Kosovës është vëllazërore

EPOKA
ERE

Veton ZYMBERI

CYRIL, 30 GUSHT - Kombëtarja e Zvicrës e ka publikuar listën e futbollistëve të ftuar për ndeshjet e shtatorit ku do të përballen me Kosovën në stadiumin "Fadil Vokrri" më 9 shtator, pastaj tri ditë më vonë e presin Andorrën. Në listën e zvicranëve janë katër futbollistë me prejardhje shqiptare: Granit Xhaka, Xherdan Shaqiri, Ardon Jashari dhe Uran Bislimi. Pjesë e listës janë edhe Kobel, Sommer, Mvogo, Akanji, Elvedi, Fernandes, Rodriguez, Schar, Zesiger, Freuler, Itten, Ndoje, Okafor, Soë, Steffen, Ugriniq, Vargas, Zakaria. Trajneri i Zvicrës, Murat Yakin e ka quajtur ndeshjen ndaj Kosovës si vëllazërore. "Nga shorti e dija se kjo mund të ishte një nga ndeshjet më të vështira në grup. Gjithashtu emocionalisht. Ju keni lojtarë të lidhur me Zvicrën, ne kemi lojtarë të lidhur me Kosovën. Por emocionet në këtë



duel vëllazëror do të jenë vetëm pozitive", ka thënë Yakin. Përballja për kualifikimet e Kampionatit Evropian mes Kosovës dhe Zvicrës zhvillohet më 9 shtator nga ora 20:45. Federata zvicrane e futbollit ka dalë me një njoftim për tifozët zvicranë që duan të blejnë bileta për këtë përballje. Tifozët zvicranë kanë mundësinë të

blejnë bileta për ndeshjen Kosovë - Zvicër më 9 shtator 2023 në Prishtinë. Biletat në sektorin e tifozëve të Zvicrës kushtojnë 5 euro. Mund të blihen maksimumi 4 bileta për porosi. Lidhja përkatëse nga Federata e Futbollit të Kosovës do të postohet në faqen www.football.ch të mërkurën më 30 gusht në ora 14:00.

Michael Jordan: Ky është organizatori më i mirë në historinë e NBA-s

NJU JORK, 30 GUSHT - Legjenda e NBA-s, Michael Jordan, ka folur për organizatorin më të mirë të historisë. Sipas tij, Magic Johnson meriton këtë vlerësim, duke lavdëruar ish-basketbollistin me të cilin ka dubluar mjaft herë në karrierën e tij. Kjo deklaratë e Jordan erdhi pasha asaj të Stephen Curry, që së fundi e ka quajtur veten si organizatorin më të mirë në histori. Në opinionet e basketbollistëve për organizatorin më të mirë ka ndërhyrë edhe Michael Jordan. "Nuk jam dakord me Curryn. Pa asnjë dyshim që organizatori më i mirë në histori është Magic Johnson. E pranoj që Curry është shumë pranë tij, por Magic është para të gjithëve", u shpreh Jordan në një intervistë. "Curry është padyshim një snajper i jashtëzakonshëm, i saktë në gjuajtjet nga distanca. Ndoshta më



i miri në histori në këtë aspekt. Lëvizja e tij krijon mundësinë për gjuajtje për të dhe shokët e skuadrës", ka deklaruar Jordan. "Ka një statistikë të shkëlqyer, 43% të realizimit të gjuajtjeve nga distanca, por ishte Magic Johnson

ai që shpiku "triple-double", pasi e bën më të rëndësishëm impaktin e tij në çdo ndeshje. Magic ishte më i miri, ka fituar edhe 5 tituj në NBA. Besoj se e kuptoni sensin e diskutimit tim", u shpreh Michael Jordan.

SHKURT

Haalandi shpallet lojtari më i mirë i vitit në Angli

Erling Haaland është kurorëzuar nga Sindikata e Futbollistëve Anglez me anë të votave si lojtari më i mirë i sezonit që lamë pas. 36 gola në 35 ndeshje në Premier Ligë dhe me tripletën e famshme me Manchester City që në debutimin e tij sezonal, nuk kishte dyshime se Haaland do të ishte lojtari më i votuar për këtë çmim prestigjioz. Nga ana tjetër, Bukayo Saka i Arsenalit, është përzgjedhur si lojtari i ri më i mirë i vitit në Angli.

Sainz: Ka vetëm një mënyrë që Ferrari të fitojë një garë këtë sezon

Piloti spanjoll i Ferrari, Carlos Sainz, shpreson që këtë sezon "kokëkuqja" të fitojë të paktën një garë në botërorin e Formula 1. Madje objektivi është triumfi këtë fundjavë në garën e Monza, në Itali, në shtëpinë e Ferrari. "E di që mediat e konsiderojnë si të pamundur që ne të fitojmë një garë. E di që shanset janë të vogla përballë Red Bull, por askush nuk është i përkryer. E di që në një moment të sezonit, Red Bull do të bëjë një gabim. Unë do të përballem çdo fundjavë në garë duke menduar që të jem në vendin e duhur për të përfituar nga ai gabim", tha Sainz. "Mentaliteti im është ky, që të jem i pranishëm kur të më jepet mundësia. Edhe në vitet kur dominonte Ferrari, Red Bull apo Mercedes, ka qenë gjithnjë një garë ku mund të bëje diferencën apo mund të ndodhte diçka. Në të kundërt, jam i motivuar për të luftuar për të kapur podiumin", u shpreh Carlos Sainz.

'La Gazzetta dello Sport': Roma nuk e dëshiron Ramosin

Pas transferimit të Romelu Lukaku te Roma, emri i Sergio Ramos filloi të qarkullojë në Itali, si një përforcim i mundshëm për fundin e merkatos, pasi Jose Mourinho kërkon të forcojë mbrojtjen Sipas gazetës italiane "La Gazzetta dello Sport", Roma e mohon këtë informacion. Mourinho dhe Ramos tashmë janë takuar në Madrid dhe tifozët e Romës do të dëshironin që ata të takoheshin sërish në Romë. Kujtojmë që spanjollit është pa ekip, pasi u largua si lojtar i lirë nga Paris Saint Germain.

Kane: Bayerni ka mentalitet fituesi

Ka mbërritur vetëm prej disa javësh në Bayern Munchen, por sulmuesi 30-vjeçar anglez Harry Kane po mahnit me paraqitjet e tij. Ai ka realizuar tri gola dhe një asistim në dy ndeshjet e luajtura deri më tani. As Robert Lewandowski nuk ka pasur këto shifra në fillimet e tij me Bayernin. Gjithsesi, fjalët e sulmuesit anglez, që u ble për 100 milionë euro nga Tottenham, kanë ngrohur të gjithë tifozët "bavarezë". "Te Bayerni ka një mentalitet fituesi", u shpreh Harry Kane, që me Tottenham nuk fitoi asgjë. "Ky ekip do të më bëjë një sulmues më të mirë dhe do të më ndihmojë për t'u përmirësuar në të ardhmen. E doja me gjithë shpirt dhe dëshirë këtë përvojë të re, të luftoja për trofe dhe të provoj të fitoj Ligën e Kampionëve. Ky ekip i ka mundësitë", ka thënë Kane, që synon shumë me skuadrën e tij të re.

Kolo Muani: E falënderoj Frankfurtin, por tani dua të luaj për PSG-në

Randal Kolo Muani ia ka kërkuar publikisht klubit të tij, Eintracht Frankfurt që ta shesë te Paris Saint-Germain. Në një prononcim për "Sky Sport", sulmuesi francez theksoi se

ndjehet shumë falënderues ndaj Frankfurt-it, por shtoi se tashmë dëshiron që të nis një aventurë të re me PSG-në, me parizienët që e kërkojnë prej kohësh 24-vjeçarin. "I

detyrohem shumë Eintracht Frankfurt. Gjithmonë i kam respektuar tifozët dhe jam sjellë gjithmonë në mënyrë shumë profesionale. Gjithmonë kam dhënë gjithçka për klubin deri

në fund. Megjithatë, nuk është sekret që Paris Saint-Germain më bëri një ofertë të rëndësishme. Lëvizja në Paris tani është një mundësi unike për mua. Do të doja të firmosja

me PSG-në dhe gjithashtu e kam informuar klubin tim. Shpresoj që Eintracht ta pranojë ofertën dhe ky transferim të bëhet i mundur për mua", ka thënë Kolo Muani.



Prishtinë, 31.08.2023

NJOFTIM PUBLIK

Shoqëria „VITA ENERGY“ SH.P.K., me numër Unik Identifikues 811159971 me adresë: Lagjja Marigona Rezidence, Preoce, Graçanicë, Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 13 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, me datë 07.07.2023 ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare me kapacitet të instaluar prej 3 MW ZK Kodra e Hutit, Komuna e Gjakovës, Republika e Kosovës.

Shoqëria „VITA ENERGY“ SH.P.K., për projektin solar me kapacitet të instaluar prej 3 MW ZK Kodra e Hutit, Komuna e Gjakovës, me rastin e aplikimit, ka dorëzuar në ZRRE dëshmitë për marrje të AUTORIZIMIT siç janë:

- Pëlqimin Mjedisor Nr.22/2014/ dt.09.06.2022 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Vendimin për Leje Ndërtimi për “Ndërtimin Ngritjen e Impiantit Fotovoltaik (Parkut Solar) për prodhimin e energjisë elektrike prej 3 MW ZK – Kodra e Hutit Komuna e Gjakovës” nr. 07/351/02-9247/2023 dt. 21.06.2023 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjakovës;
- Pëlqimin Elektroenergjetik Nr. 318 dt.17.01.2023 të lëshuar nga KEDS SH.A.;
- Dëshmi mbi të drejtat pronësore (Kontratat për shfrytëzimin e tokës);
- Deklaratën për shitjen e energjisë;
- Raportet financiare për 3 vitet e fundit;
- Konfirmimin bankar për posedimin e 10% të vlerës së investimit
- Studimi i fizibilitetit teknik dhe financiar;
- Plani i Biznesit; dhe
- Plani Dinamik i Realizimit.

Aplikuesi ka dorëzuar edhe kërkesat administrative sipas aplikacionit dhe ka dorëzuar kërkesën që, energjia e prodhuar nga ky projekt do të shitet bazuar në çmimet e tregut.

Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund ti paraqesin në ZRRE brenda 8 (tetë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi në adresën elektronike: kusarir@gmail.com dhe LEGAL-LECEENSING@ero-ks.org

Qasja në dosjen e Aplikimit, për të cilat Aplikuesi ka lejuar qasje, mundësohet për aq sa e lejon legjislacioni për Qasje në Dokumentet Publike.



Prishtinë, 31.08.2023

NJOFTIM PUBLIK

Shoqëria „Eco Park Group“ L.L.C., me numër Unik Identifikues 810844432 me adresë: Rruga Madanaj, Qafa pn Gjakova, Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 13 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, me datë 23.08.2023 ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare me kapacitet të instaluar prej 6 MW ZK Kodra e Hutit, Komuna e Gjakovës, Republika e Kosovës.


Shoqëria „Eco Park Group“ L.L.C., për projektin solar me kapacitet të instaluar prej 6 MW ZK Kodra e Hutit, Komuna e Gjakovës, me rastin e aplikimit, ka dorëzuar në ZRRE dëshmitë për marrje të AUTORIZIMIT siç janë:

- Pëlqimin Mjedisor Nr.23/2779/ dt.09.08.2023 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Aktvendimin për Leje Ndërtimi për “Ndërtimin Ngritjen e Impiantit Fotovoltaik (Parkut Solar) për prodhimin e energjisë elektrike prej 6 MW ZK – Kodra e Hutit Komuna e Gjakovës” nr. 07/351/03-9335/2023 dt. 22.05.2023 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjakovës;
- Pëlqimin Elektroenergjetik Nr. 6695 dt.27.06.2023 të lëshuar nga KEDS SH.A.;
- Dëshmi mbi të drejtat pronësore (Kontratat për shfrytëzimin e tokës);
- Deklaratën për shitjen e energjisë;
- Raportet financiare për 3 vitet e fundit;
- Konfirmimin bankar për posedimin e 10% të vlerës së investimit
- Studimi i fizibilitetit teknik dhe financiar;
- Plani i Biznesit; dhe
- Plani Dinamik i Realizimit.

Aplikuesi ka dorëzuar edhe kërkesat administrative sipas aplikacionit dhe ka dorëzuar kërkesën që, energjia e prodhuar nga ky projekt do të shitet bazuar në çmimet e tregut.

Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund ti paraqesin në ZRRE brenda 8 (tetë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi në adresën elektronike: leke.sahatciu@gmail.com dhe LEGAL-LECEENSING@ero-ks.org

Qasja në dosjen e Aplikimit, për të cilat Aplikuesi ka lejuar qasje, mundësohet për aq sa e lejon legjislacioni për Qasje në Dokumentet Publike.



Prishtinë, 31.08.2023

NJOFTIM PUBLIK

Shoqëria „VBS“ SH.P.K., me numër Unik Identifikues 811159963 me adresë: Lagjja Marigona Rezidence, Preoce, Graçanicë, Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 13 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, me datë 07.07.2023 ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare me kapacitet të instaluar prej 3 MW ZK Kodra e Hutit, Komuna e Gjakovës, Republika e Kosovës.

Shoqëria „VBS“ SH.P.K., për projektin solar me kapacitet të instaluar prej 3 MW ZK Kodra e Hutit, Komuna e Gjakovës, me rastin e aplikimit, ka dorëzuar në ZRRE dëshmitë për marrje të AUTORIZIMIT siç janë:

- Pëlqimin Mjedisor Nr.22/2015/ dt.15.06.2022 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Vendimin për Leje Ndërtimi për “Ndërtimin Ngritjen e Impiantit Fotovoltaik (Parkut Solar) për prodhimin e energjisë elektrike prej 3 MW ZK – Kodra e Hutit Komuna e Gjakovës” nr. 07/351/02-9248/2023 dt. 21.06.2023 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjakovës;
- Pëlqimin Elektroenergjetik Nr. 314 dt.17.01.2023 të lëshuar nga KEDS SH.A.;
- Dëshmi mbi të drejtat pronësore (Kontratat për shfrytëzimin e tokës);
- Deklaratën për shitjen e energjisë;
- Raportet financiare;
- Konfirmimin bankar për posedimin e 10% të vlerës së investimit
- Studimi i fizibilitetit teknik dhe financiar;
- Plani i Biznesit; dhe
- Plani Dinamik i Realizimit.

Aplikuesi ka dorëzuar edhe kërkesat administrative sipas aplikacionit dhe ka dorëzuar kërkesën që, energjia e prodhuar nga ky projekt do të shitet bazuar në çmimet e tregut.

Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund ti paraqesin në ZRRE brenda 8 (tetë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi në adresën elektronike: kusarir@gmail.com dhe LEGAL-LECEENSING@ero-ks.org

Qasja në dosjen e Aplikimit, për të cilat Aplikuesi ka lejuar qasje, mundësohet për aq sa e lejon legjislacioni për Qasje në Dokumentet Publike.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Xhemile Hajdini shpall të pavlefshme Licencën e Punës me nr.KO-1288-05-20, 23.06.1993.

- Shkodran Latifi shpall te pavlefshme dëftesat, certifikatën dhe diplomën QK “11 Marsi “ Prizren.

- Naser Halimi shpall te pavlefshme dëftesën e vitit I,II, shme “ Ymer Prizreni “ Prizren.

- Driton Hoxhaj shpall te pavlefshme diplomën shme “ Ymer Prizreni “ Prizren.

- Bertan Temollari shpall te pavlefshme dëftesën e kp I - V shfmu “ Mati Logoreci “ Prizren.

- Samuel Gjetaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës “Nexhmedin Nixha”.

- Edonis Avdiu shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore “Fazli Grajqevci”.

- ArbnoreHoxhaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme Ekonomike “Kadri Kusari”.

- Lyra Kendusi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi”.

- MuhametMakolli shpall të pavlefshme dëftesën e vitit të parë të Gjimnazit “AhmetGashi” Prishtinë.

- Imer Z. Beka B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811332577 Prishtinë.

- Tehnoburimi D.D SH.A shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB 810548307.

- Ibrahim Bajrami shpall të pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën e shkollës se mesme “Arkitekt Sinani”.

- Lejla Peci shpall të pavlefshme diplomën e shkollës se mesme “Xheladin Deda”.

